



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5. dhe nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (tutje: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), nenit 11 paragrafi 4 dhe 5, si dhe nenit 12 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7. të Rregullores Nr. 03/2023, për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 21.02.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti APK-DPKI-06-1703/24, për zyrtarin e lartë z. Fadil Bejta, Anëtar i Bordit Mbikëqyrës në Ndërmarrjen Publike “Trepça” Sh.A, për shkak se nuk ka prova që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve publike sipas dispozitave të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur me pretendime për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas pranimit të denoncimit nga një raportues i rastit, ka filluar procedurën e shqyrtimit të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve publike.

Denoncuesi i rastit ka ngrit pretendimin, citojmë nga kërkesa e raportuesit; “Fadil Bejta është në konflikt interesi që lidhet me ushtrimin e funksioneve Kryesues i Komitetit të Auditimit, Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike “Trepça” Sh.A dhe Koordinator i të Hyrave në Ndërmarrjen Publike “Telekomi i Kosovës” Sh.A. Konflikti i interesit lidhet në mes të funksioneve Kryesues i Komitetit të Auditimit dhe Anëtar i Bordit në Trepçë, këto pozita kanë konflikt interesi sepse Qeveria është hartuese e politikave të ndërmarrjeve publike dhe Qeveria vlerëson performancën e Anëtarëve të bordit të Trepçës dhe ushtrimi i pozitës Kryesues i Komitetit të Auditimit në zkm është konflikt interesi”.

Agjencia konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së papajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve publike.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit me qëllim të sqarimit të gjendjes faktike, ka kërkuar dhe pranuar dokumentacion relevant përkitazi me rastin konkret.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit është konstatuar gjendja faktike si në vijim;

Me vendimin nr.05/212 të datës 10.07.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Fadil Bejta, është emëruar Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Trepça Sh.A.

Në Ndërmarrjen Publike Telekom i Kosovës” Sh.A, Fadil Bejta e ushtron funksionin Menaxher- Monitorim, Kontrolle dhe Barazim sipas kontratës së punës nr.3025 të datës 16.04.2024, ndërsa për punën e tij i raporton Menaxherit të Departamentit për Sigurimin e të Hyrave.

Fadil Bejta është emëruar Kryesues i Komitetit të Auditimit në Zyrën e Kryeministrin të Republikës së Kosovës me vendimin nr.606/2023 të datës 30.11.2023.

Neni 20 i Ligjit nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike ka përcaktuar se;

1. Komiteti i Auditimit është organ i pavarur këshillëdhënës për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik, dhe mbështetës për auditorët e brendshëm.
2. Komiteti i Auditimit themelohet dhe funksionon në subjektet e sektorit publik në bazë të kriterëve të vendosura nga Ministri i Financave.
3. Komiteti i Auditimit përbëhet nga tre (3) ose pesë (5) anëtarë, ku dy të tretat (2/3) janë të jashtëm nga fusha përkatëse e auditimit, ndërsa pjesa tjetër nga stafi i brendshëm i subjektit të sektorit publik.

Ushtrimi i të drejtave të aksionarit është përcaktuar me nenin 5 paragrafi 5.1 të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike në të cilin shprehimisht thuhet;

Ushtrimi i të Drejtave të Aksionarit

5.1 Qeveria ka kompetencën ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në NP-të Qendrore. Qeveria do të vendos mbi këto çështje me shumicë të thjeshtë votash. Me qëllim të përgatitjes së debatit në Qeveri, një komision i zgjedhur i Ministrave do të paraqesë propozime ose vërejtje mbi këto çështje. Aktet nënligjore të cilat do të miratohet në përputhje me nenin 42 do t'i përcaktojnë rregullat dhe procedurat e komisionit të zgjedhur. Komisioni i zgjedhur gjithnjë duhet të përfshijë Ministrin e Ekonomisë dhe Financave; Ministria e Energjisë dhe Minierave; Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë; Ministrin e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit; dhe Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Vendimet e Qeverisë do të zbatohen nga Ministri, i cili, për këtë qëllim, ka të drejtë

të veprojë në emër të Republikës së Kosovës dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 3 i Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ka përcaktuar si në vijim;

Neni 5 i ligjit bazik, paragrafi 5.1. në pjesën e dytë të paragrafit, pas fjalisë “Komisioni i zgjedhur gjithnjë duhet të përfshijë...”, fshihet “Ministrin e Ekonomisë dhe Financave” dhe zëvendësohet me tekstin “Ministrin përkatës për Zhvillim Ekonomik”, fshihet “Ministrin e Energjisë dhe Minierave” dhe zëvendësohet me “Ministrin përkatës për Financa”, fshihet “Ministrin e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit” dhe zëvendësohet me “Ministrin e Infrastrukturës”.

Dispozita e nenit 7 paragrafi 7.4 të Ligji nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ka përcaktuar se;

7.4 Njësia për Politikat dhe Monitorimin e NP do të shqyrtojë procesverbalet e cilës mbledhje të Bordeve të Drejtorëve dhe Komisioneve të Auditimit të NP-ve si dhe të gjitha dokumentet e dorëzuara. Kurdo që është e nevojshme, Njësia për Politikat dhe Monitorimin e NP do të kërkojë dorëzimin e të dhëna më specifike dhe po ashtu mund të kërkojë takim me Bordin e Drejtorëve. Kurdo që këto procesverbale, dokumente ose të dhëna shfaqin shqetësime lidhur me performancën e Bordit të Drejtorëve, menaxhmentit të NP-së ose vetë NP-së, Njësia për Politikat dhe Monitorimin e NP-ve do ta njoftojë Aksionarin(ët) përkatës mbi këto shqetësime.

Ligji nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik ka përcaktuar rregulla, papajtueshmëri dhe kufizime për zyrtarët gjatë ushtrimit të funksionit.

Zyrtar i lartë publik në Ligjin nr.06/L-011 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit konsiderohen zyrtarët e lartë publikë të përcaktuar sipas Ligjit 08/L-108 për Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave.

Funksioni i Menaxher- Monitorim, Kontrollë dhe Barazim në Telekomin e Kosovës Sh.A, e as funksioni Kryesues i Komitetit të Auditimit në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës nuk hyjnë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik sipas Ligjit 08/L-108 për Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave.

Ushtrimi i funksionit Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Trepça Sh.A, Menaxher-Monitorim, Kontrollë dhe Barazim në Telekomin e Kosovës Sh.A dhe Kryesues i Komitetit të Auditimit në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës nuk paraqet papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik bazuar në dispozitat e Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Lidhur me pretendimin se konflikti i interesit lidhet në mes të funksioneve Kryesues i Komitetit të Auditimit dhe Anëtar i Bordit në Trepçë, këto pozita kanë konflikt interesi sepse Qeveria është hartuese e politikave të ndërmarrjeve publike dhe Qeveria vlerëson performancën e Anëtarëve të bordit të Trepçës dhe ushtrimi i pozitës Kryesues i Komitetit të Auditimit në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës është konflikt interesi”.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit pas shqyrtimit të pretendimit konstaton se ky pretendim nuk paraqet papajtueshmëri sepse Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nuk ka përcaktuar dispozitë kufizuese për situatën konkrete.

Gjatë ushtrimit të funksionit publik eventalisht mund të shfaqen situatat e konfliktit “rast për rast” të interesit në rrethanat e tilla zyrtari duhet të veprojë në pajtueshmëri me nenin 13 pika 3 të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në të cilën shprehimisht thuhet;

1. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.

Ligji nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në nenin 19 ka përcaktuar masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave, në të cilën shprehimisht thuhet;

1. Në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari sipas rastit dhe rrethanave:

1.1. transferon interesin privat dhe të drejtat në drejtimin e ndërmarrjes sipas përcaktimeve të nenit 15 të këtij ligji;

1.2. merr masa për vetëpërgjashtimin ose përjashtimin paraprak nga procesi i vendimmarrjes, diskutimit dhe votimit të çështjes në konflikt me përjashtim të rasteve të përcaktuara shprehimisht me ligj;

1.3. jep dorëheqjen nga detyrat, funksionet ose veprimtaritë që janë në konflikt ose të papajtueshme me funksionin e tij publik;

1.4. dorëhiqet nga funksioni publik.


Agjencia është autoritet qendror përgjegjës për zbatimin e dispozitave të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit me të cilin është përcaktuar se: “Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: “Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)



Vl. Buleshkaj

Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

